

E DIELA E PALLMAVE

THIRRTORET, T. T. II

Këndohen dhjetë, dyke i përsëritur të gjitha.

Hir i Shpirtit Shenjt na mblodhi sot; edhe të gjithë e ngremë Kryqin dhe thomi: I bekuar je ti që vjen, më emërin e Zotit, hosanna më të lartat.

Fjal' e Perëndisë dhe Atit, që e ka fronin në qjell, edhe këmbët mi dhenë, hipi sot mi një kafshë të përunjur; përandaj të bijtë e Hebrenjve, i duallnë përpara me degë, dhe i thërrisnin me zë të math; Hosanna më të lartat, i bekuar je ti që vjen, o Mbret i Israelit.

Ejani të gjithë sot, o Israëli i ri, o Kishë e ish-paganëve, dhe le të thërresim me Profetin Zakaria: Gëzohu o bijë Sion, se ja Mbreti yt po vjen, i hipur mi një kafshë të përunjur, thirr pra tok me djemat: Hosanna më të lartat, i bekuar je ti që vjen, o Mbret i Israelit.

Parëljajmërove Ngjalljen e Shentjës kur e ngrite Lazarin prej varrit, ku dergjej që prej katër ditësh; përëndaj djemat e popullit të dashur, të pritnë me degë dhe me brohori, kur hyre si mbret në Jerusalem, gjashtë ditë përpara Pashkës.

Kur ardhi Jesuj në Bethani, iu-afruan Dishepujtë dhe e pyetnë: “Ku do të ta gatitim gostinë e Pashkës?” Dhe Jesuj u-përgjey: “Shkoni në katundin kundrejt, atje do të gjeni një njeri me një shtëmbë, bjerini pas, edhe i thoni: “Mësonjësi thotë. “Do ta bënj Pashkën me dishepujtë e mi në shtëpi tënde.”

LAVDI. Hiri i Shpirtit Shenjt na mblodhi sot; edhe të gjithë e ngremë Kryqin dhe thomi: I bekuar je ti që vjen, më emërin e Zotit, hosanna më të lartat.

TANI. *Gjithajo.*

PASVARGJET, T. II.

PAS IKOS TU EFRATHA

Ndrit o Sion i ri, me degë dhe me lule, këndo me gjithë djemat, se ja ku të vjen Mbreti, me Kryq të sjell shpëtim dhe gas.

Ndrit o Adam i ri, me Evën dhe Profetët, se ja ku na vjen Zoti, edhe na sjell shpëtimin, me anën e Pësimeve.

Krishti që lart në qjell, me Engjëj lavdërohet, mi

dhenë tani zbriti, dhe djemat e këndojnë, se njerësve u sjell shpëtim.

LAVDI DHE TANI. Dridhem dhe hosanna, po të thërres me degë, se zbritë përmi dhenë, që t' i shpëtosh të mjerët, me vojte dhe me Kryqin tënt.

PERLESHORET, T. I.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkme përpara Pësimit tënt, e ngrite Lazarin prej së vdekurësh, o Krisht Perëndi; përëndaj dhe ne posi djemat, dyke mbajtur shenjat e mundjes, ty po të thërresim mundësit të vdekjes. Hosanna ti më të lartat, i bekuar je ti që vjen, me emërin e Zotit.

TANI. U-varrosmë me pagëzimin tok me ty, o Krisht Perëndia ynë, u-vlerësuam për jetën pa vdekje me Ngjalljen tënde, dhe të thërresim me lavdi: Hosanna më të lartat, i bekuar je ti që vjen, më emërin e Zotit.

NDENJESORET

PAS KATEPLLAJI IOSIF

T. IV. Dyke mbajtur mëndërisht, degë dhe lule me triumf, posi djemat Zotin Krisht, le ta hymonjmë besërisht, le t'i thërresim me zë të math Shpëtimtarit: I bekuar je se ti, ardhe për njerëzit mi dhe, për shpëtim dhe për çlirim, nga çdo mëkat e çdo mallkim, edhe Adam i ri për ne u-bëre o njeridashës; për ne të gjitha, i regullove, o Perëndi lavdi më ty.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

PAS EPEFANIS SIMERON

T.IV. Shën Lazari katër dit, dergjej në varrin, po e ngriti Zoti Krisht, dhe në qytet Jerusalem, u-prit prej

djemave si një Mbret: Se i bekuar, je ti Hosanna o Zot.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

PAS TO PROSTAKHTHEN MISTIKOS

T.T.IV. Ti që rri mi Kerubimet dhe mi ushin, dhe u-nise për Pësimin dhe për Kryqin, dyke dashur u-unje dhe si Mbret u-prite, me degë, dhe me dafina dhe Hosanna; thërrisnin, me brohori në Jerusalem, gjithë djemat e popullit, o Shpëtimtar o Zoti Krisht: I bekuar je ti që vjen, për shpëtimin e njerësve.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

SHKALLESA KREMTORE, T. IV.

Që prej djalërisë, shumë pasione më lëftojnë, po ti përkrah-më, dhe shpëto-me o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sinonën, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të fishkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shentjës merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet me paqësi, dhe ndriçohet prej njësisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shentjës rrjedhin buri- met e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetëlindje.

PAREVARGU. Nga goja e foshnjave dhe thithanikëve gatite lavdërime.

Pastaj këndohet menjëherë:

UNJILLI I MENGJEZIT PAS MATTHEUT

Më atë kohë, Jesuj, kur u-afua në Jerusalem dhe ardhni në Bethfage pranë malit të Ullinjve, dërgoj dy dishepuj, dhe u tha: “Shkoni në katundin kundrejt, edhe

menjëherë do të gjeni një ushe, të lidhur me një pulisht; zgjidhni dhe sillmini. Dhe në ju thënë njeri gjë, i thoni se Zoti ka nevojë për ato; dhe menjëherë do t'i dërgonjë.” Dhe kjo punë e tërë u-bë, që të mbushet fjala, që ka thënë Profeti: “Thojini bijës së Sionës: ‘Ja, Mbreti yt të vjen i butë dhe i hipur mi një ushe me një pulisht të zgjedhës.’” Dhe dishepujtë shkuan, dhe bënë ashtu, sikundër i porrositi Jesuj, dhe ia suallnë ushen me pulishtin, dhe u vunë robot e veta përsipër, dhe e hipnë mi ato. Dhe gjindja e madhe shtronin robot e veta mbë udhë; të tjerë prisnin degë prej lisave, dhe i shtronin përdhe. Edhe gjindja, që venin përpara dhe pas, thërrisnin edhe thoshin: “Hosanna, o i Biri i Davidit; i bekuar je ti që vjen më emrin e Zotit; hosanna më të lartat.” Edhe kur hyri në Jerusalem, i tërë qyteti u-tunt, edhe të gjithë pyesnin: “Cili është ky?” Dhe disa përgjigjeshin: “Ky është Profeti Jesu nga Nazareti i Galileës.” Dhe Kryepriiftinjtë dhe Shkronjësit, kur i panë çudirat, që bënte, dhe djemat, që thërrisnin në Shenjtëroren, dhe thoshin “Hosanna, o i Biri i Davidit,” u-zëmëruan, dhe e pyetnë: “A i dëgjon fjalët, që të thonë këta?” Edhe Jesuj u-përgjigj: “Po; vallë nukë kini kënduar nonjëherë se nga goja e foshnjave dhe thithanikëve gatite lavdërime?” Dhe i la edhe dolli jashtë qytetit në Bethani; dhe mbeti natën atje.

Pas Psalmi 51 këndohet:

LAVDI DHE TANI, T.II. Sot Jesuj hyri në qytetin e shenjtë, dhe u dha funt marrësive pagane, të vjetëru- ara dhe bajate

Mëshiro-më, o Perëndi mëshirëplot, edhe shuaji paudhë- sit e mia.

T.T. II. Hiri i Shpirtit Shenjt na mblodhi sot; edhe

të gjithë e ngremë Kryqin dhe thomi: I bekuar je ti që vjen, më emrin e Zotit, hosanna më të lartat.

SHKURTORJA, T. T. II.

Në qjellin si Mbret mi fron, në dhenë si rob mi ush, na je çfaqur o Krisht Perëndi, dhe këndimet e Engjëjve, dhe lëvdatat e djemave, të buçisnin me zë të math: I bekuar je ti që vjen, për shpëtimin e njerësve.

SHTEPIA

E dërmovë Ferrin, e përmbyse vdekjen, dhe e ngjalle botën; përandaj djemat të brohoritnin si mundës, o Krisht, edhe thërrisnin: Hosanna, o i Biri i Davidit, i bekuar je ti që vjen, për shpëtimin e njerësve.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Pallmave, kremtojmë hyrjen e lavdëruar të Zotit tonë Jesu Krisht në Jerusalem.

Me mëshirën tënde të patreguar, o Perëndia ynë, vlerësona ta shikojmë Ngjalljen tënde gazmore, dhe mëshirona. Amin.

ZBRITESORET, T. IV.

OFTHISAN E PIJE

I. Ja u-pa, Det i Kuq me burimet, pa ujë si një stere; edhe u-zbuluan themelet e avushës dhe të valave, se me një nefshë ti o Zot, e qërtove dhe i vure fre, dhe përtejza e shpëtove popullin, që këndonte këngë mundëse për ty o Zot.

III. Pinë ujë prej shkëmbit të shkretëtirës, populli yt Israel me urdhërin tënt; edhe shkëmbi je ti o Krisht,

o jetë dhe burim; mi ty u-shigurua Kisha e cila të thërret: Hosanna i bekuar je, ti që vjen për ne.

IV. Shpëtimtari Zoti Krisht, Zoti ynë shigurisht, do të vinjë pa vonim, prej malit hieplot dhe të dëndur, të Virgjëreshës së kulluar, Profet' i Shenjtë na tha: Të gjithë pra thërresim: Zoti i fuqishim lavdi më ty.

V. Shko dhe ngjit-u lart në malin Sion, ti që na ungjillëzon, ngrer-e zërin dhe Jerusalemit, i lëçit me forc' e brohori: Lavdërimë janë folur përmi ty, o qytet i Zotit Krisht, paqe Israelit gjithënjë, dhe shpëtimi i kombeve.

VI. Me gas dhe me dëfrim bërtitnë shpirtet e të Drëjtëve: Ja tani në tërë botën, dhjat' e re për ne po vjen, edhe populli po përsëritet, me gjakun e Zotit Krisht.

VII. Ti që shpëtove të tre Djemat, Abramianë prej furrës, dhe e ndriçove popullin, për mynxyrën kundër të pafajmëve, o Perëndi i Atërve, ti je i lavdëruar dhe i bekuar.

VIII. Dëfre o qytet Jerusalem, dhe kremtëroni o besnikë në Sion, se Mbret' i qjellit dhe i tërë botës, Zoti i gjithë Forcave ardhi. Pra le ta adhuronjë tërë dheu, dhe me brohori le t'i thërresë. Gjithë krijesat, hymnojeni Zotin Krisht.

KENGA IX.

Perëndi dhe Zot përmi dhenë na u-çfaq; pra mbli-dhuni me nxitim, ta madhështojmë Jesunë me gëzim e brohori, me pallma dhe degë dyke thirrur me zë të math. I bekuar është ay që vjen, më emërin e Zotit, Shpëtimtari ynë.

Paganë përse po tërboheni? Shkronjës dhe Prif-

tërinj, ç' kotësira po mejtoheni? Ç' pyesni kush është kur djemat, i thërresin me zë të math: I bekuar është ay që vjen, më emërin e Zotit, Shpëtimtari ynë.

Zoti Perëndi që si ky s' ka asgjëkunt, mënyrën më të mirë e caktoj, dhe popullit të dashur Israel iu-çfaq, dhe pastaj me njerëzinë, u-përzie dhe u-njoh: I bekuar është ay që vjen, më emërin e Zotit, Shpëtimtari ynë.

ZBRITESORJA

Perëndi dhe Zot përmi dhenë na u-çfaq; pra mbli-dhuni me nxitim, ta madhështojmë Jesunë me gëzim dhe brohori, me pallma dhe degë dyke thirrur me zë të math: I bekuar është ay që vjen, më emërin e Zotit, Shpëtimtari ynë.

DERGIMESORET, T. II.

Në vëndin e Dërgimësoreve këndohet tri herë Vargu pasonjës:

I shenjtë është Zoti Perëndia ynë. (3 herë)

LAVDERIMET, T. IV.

Gjindja e madhe o Zot, t'i shtronin robat përdhe, të tjerë prisnin degë prej lisave, dhe me brohori të thërrisnin: Hosanna o i Biri i Davidit, i bekuar je ti që ke ardhur, dhe që do të vish përsëri, më emërin e Zotit.

Kur hyre në qytetin e shenjtë o Zot, i hipur mi një kafshë të përunjur, djemat të pritnë si Mbret mi Kerubimet, përandaj pra të thërrisnin: Hosanna më të lartat, i bekuar je ti që ke ardhur, dhe që do të vish përsëri, më emërin e Zotit.

Dilni o paganë, dilni o popuj, dhe shikojeni Mbretin e qiellit, që hyn në Jerusalem, i hipur mi ushin si mi

Kerubimet. Po djemat e njohën dhe i thirrnë: Hosanna më të lartat, o Zot mëshirëplot.

Krishti Perëndia ynë, e parëljajmëroj Pashkën, kur e ngriti nga varri Lazarin, të vdekur që prej katër ditësh. Përandaj djemat e Hebrenjve, i duallnë përpara, me pallma dhe me degë, dhe i thërrisnin me zë të math: Hosanna më të lartat, i bekuar je ti që vjen, më emërin e Zotit.

LAVDI DHE TANI, T. T. II.

Gjashtë ditë përpara Pashkës, ardhni Jesuj në Bethani, dhe iu-afruan dishepujtë dhe e pyetnë: "Ku do të ta gatitim gostinë e Pashkës?" Dhe Jesuj u-përgjeq. 'Shkoni në katundin kundrejt, atje do të gjeni një njeri me një shtëmbë, bjerini pas edhe i thoni: "Mësonjësi thotë: 'Do ta bën Pashkën me dishepujt' e mi në shtëpinë tënde."

Doksollogji e Madhe. Në Hyrjen këndohen:

PERLESHORET

T.I. Vërtetove Ngjalljen e përbashkme përpara Pësimit tënt, e ngrite Lazarin prej së vdekurësh, o Krisht Perëndi; përandaj dhe ne posi djemat, dyke mbajtur shenjat e mundjes, ty po të thërresim mundësit të vdekjes: Hosanna ti më të lartat, i bekuar je ti që vjen, më emërin e Zotit.

HYRTORJA

I bekuar është ay që vjen, më emërin e Zotit. Perëndi dhe Zot përmi dhenë na u-çfaq. Shpëtona, o i Bir' i Perëndisë, që ndënje mi një kafshë të përunjur, ne që të këndojmë Alilluia.

SHKURTORJA, T. T. II.

Në qjellin si Mbret mi fron, në dhenë si rob mi ush, na je çfaqur o Krisht Perëndi, dhe këndimet e Engjëjve, dhe lëvdatat e djemave, të buçisnin me zë të math: I bekuar je ti që vjen, për shpëtimin e njërësve.

APOSTULLI

I bekuar është ay që vjen më emrin e Zotit.
Lavdërojeni Zotin, se është i mirë.
Këndimi prej Letrës së Palit për Filipianët.

Vëllezër, gëzohuni më Zotin gjithënjë, dhe prapë ju them, gëzohuni. Butësia juaj le të bëhet e njohur për të gjithë njerëzit. Zoti është pranë; mos u-kujdesni për gjë, po më çdo rast ia bëni të njohura lypjet tuaja Zotit me falje, lutje, dhe përhirime; dhe paqja e Perëndisë, që kapërcen çdo mëndje, do t'jua ruanjë zëmrat edhe mejtimet më Krishtin Jesu. Pra, vëllezër, mejtoni ato, që janë të vërteta, të nderuara, të drejta, të pastëra, të dashura, emërmira, të virtutme, dhe të lavdëruara. Bëni ato, që mësuat, edhe muartë, dhe dëgjuat, edhe patë prej meje. Dhe Perëndia i paqes do të jetë me ne.

UNGJILLI PAS JOANIT

Gjashtë ditë përpara Pashkës, Jesuj ardhi në Bethani, ku ishte Lazari, të cilin e ngriti nga varri. Atje, pra, i bëne darkën, dhe Martha shërbente; dhe Lazari ishte një prej të shtruarve në sofrën me atë. Edhe Maria mori një litër myrre prej nardi të fjeshtë fort të shtrenjtë, ia lyejti këmbët Jesujt, edhe ia fshiu me flokët e veta; dhe shtëpia u-mbush me erën e myrrës. Një, pra, nga dishepujt' e tij, Juda i Simonit Iskarioti, ay që e tradhëtoj pastaj, i tha: "Përse kjo myrrë nuk u-shit për tre

qint dinare, të cilat t'u jipëshin të varfërve?" Dhe këtë e tha, jo se i hante malli për të varfërit, po se ishte vjedhës, edhe kishte kuletën, dhe mbante ato, që hidhëshin brënda. Jesuj, pra, i tha: "Ler-e, se ma paska ruajtur për ditën e varrimit. Se të varfërit i kini me ju kurdoherë, po mua nukë më kini gjithënjë." Shumë prej Judenjve, pra, mësuat që ishte atje, dhe arthnë të shikonin jo vetëm Jesunë, po edhe Lazarin, të cilin e kishte ngritur nga varri. Dhe Kryepriiftinjtë bëne këshillë që ta vrisnin atë edhe Lazarin; se nga shkaku i këti shumë prej Judenjve venin, dhe e besonin Jesunë. Dhe të nesërmen një gjindje e madhe, që kishin ardhur për të kremten, kur dëgjuan se Jesuj vinte në Jerusalem, muarnë degë pallmash, i duallnë përpara, dhe e pritnë, dyke thirrur: "Hosanna, i bekuar je ti që vjen më emrin e Zotit, o Mbret i Israelit." Edhe Jesuj kishte gjetur një pulisht, edhe i kishte hipur, sikundër është shkruar: "Mos kij frikë, moj bijë e Sionit; se ja, Mbreti yt po vjen i hipur mi një pulisht prej ushi." Dhe dishepujt' e tij në krye nuk i merrnin vesh këto; po kur u-lavdërua Jesuj, ahëre u-kujtuan që këto ishin të shkruara për atë, edhe përandaj u-bënë. Dhe gjindja, që e kishin parë, dëshmonin se e thirri Lazarin nga varri, dhe e ngjalli së vdekurësh; dhe përandaj gjindja i duallnë përpara, dhe e pritnë, se kishin dëgjuar që ay e bëri këtë çudi.

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit. Në "Veçan Tërëshenjtën," këndohet:

ZBRITESORJA IX

Perëndi dhe Zot përmi dhenë na u-çfaq; pra mbli dhuni me nxitim, ta madhështojmë Jesunë me gëzim dhe brohori, me pallma dhe degë dyke thirrur me zë të

math: I bekuar është ay që vjen, më emërin e Zotit, Shpëtimtari ynë.

KUNGATORJA

I bekuar është ay që vjen më emrin e Zotit. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të "Pamë Dritën", këndohet:

PERLESHORJA, T. I.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkme përpara Pësimit tënt, e ngrite Lazarin prej së vdekurësh, o Krisht Perëndi; përandaj dhe ne posi djemat, dyke mbajtur she-njat e mundjes, ty po të thërresim mundësit të vdekjes: Hosanna ti më të lartat, i bekuar je ti që vjen, më emrin e Zotit.

PERLESHIMI

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që dignoj të hipë mi një kafshë të përunjur për shpëtimin tonë.

Për Uratën e Pallmave shiko Uratoren, f. 518.